



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 04.11.2025

Numër Protokolli: 7166/2025

A.nr.1712/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1712/2025, të datës 19.09.2025, të parashtruar nga ankuesja G.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.1712/2025, e datës 19.09.2025 e parashtruar nga ankuesja G.H.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, G.H (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), me datë 19.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në lidhje me kërkesën e datës 01.08.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 25.09.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit)
administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 6247/2025 e datës 19.09.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me Nr. 01-112-277 të datës 16.11.2024; Dëshmi e pagave nëntor 2024; Dëshmi e pagave janar dhe korrik 2025; Kërkesën e datës 01.08.2025 nga ankuesja për Sektorin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Përgjigjen në ankesë e datës 25.09.2025; Listën e pagave për ankuesen për vitin 2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës, ndërsa, organi i punësimit sipas nenit 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, me datë 16.11.2024 i ka lëshuar Aktin e Emërimit me Nr.01-112-277, ashtu që, pozitën e ankueses “Zyrtare për Kadastër”, e ka klasifikuar në Kategorinë Profesionale 2, më klasë të pagës GJ33 dhe koeficient të pagës 5.1.

Ankuesja, më datë 01.08.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar më datë 16.11.2024. Po ashtu, ankuesja në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4 Profesionale 3, ndërsa sipas shkresave të lëndës dhe thënies në ankesë organi i punësimit ka heshtur, duke mos dhënë përgjigje në kërkesën e ankueses të datës 01.08.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se e njëjta është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, e njëjta nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri, e me kërkesë që organi i punësimit të zbatojë aktin e emërimit me Nr. 01-112-277 të datës 16.11.2024 dhe ti bëjë kompensimin sipas koeficientit 5.1, duke përfshirë kompensimin në mënyrë retroaktive që nga data 16.11.2024. Kërkon të aprovet ankesa të obligohet Komuna e Prishtinës të zbatojë akt emërimit e datës 16.11.2024 dhe kompensimin sipas koeficientit 5.1 nga muaji dhjetor nga dita e nënshkrimit të akt emërimit duke llogaritur edhe rritjen e koeficientit të pagës tani në 6.1.

Në kuptim të pranishmërisë së ankesës, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: “3. Njësia/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil”, si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA), me theks të veçantë nenit 98, paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se:” 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës

administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.....”,nenit 124 paragrafit 1 ku përcaktohet se: “*1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*”, dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe : *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ* dhe si rrjedhojë duke bazuar në këtë përcaktim ligjor si dhe duke qene se ankesa i referohet heshtjes administrative të Komunës së Prishtinës në raport me kërkesën e ankueses të datës 01.08.2025, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses e ushtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.09.2025, është parashtruar para fatit ligjor për heshtje administrative, mbi arsyet se ankuesja më datë 01.08.2025 ka parashtruar kërkesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës për kompensim material sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 16.11.2024, dhe po ashtu, ankuesja në kërkesën në fjalë pretendon se është duke u paguar sipas koeficientit 4.50, GJ41-4 Profesional 3, e duke qenë se e njëjta nuk kishte marr përgjigje nga organi punëdhënës brenda afatit prej 45 ditësh siç përshihet me 98 paragrafi 2 të LPPA-së, atëherë, ankuesja pas afatit prej 7 ditësh nga skadimi i afatit 45 ditor, por jo më shumë se dy (2) muaj nga data kur Komuna e Prishtinës duhej të ofronte përgjigje në kërkesën e ankueses të datës 01.08.2025, do të duhej të parashtronte ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes administrative lidhur me kërkesën e datës 01.08.2025. Në fakt, Komuna e Prishtinës lidhur me kërkesën e ankueses të datës 01.08.2025, duhej të ofronte përgjigje deri më datë 15.09.2025, ndërsa, ankuesja 7 ditë pas këtij afati (22 shtator) dhe deri me 22 nëntor 2025, mund të ushtronte ankesë për shkak të mosveprimit, rrjedhimisht heshtjes së Komunës së Prishtinës ndërlidhur me kërkesën e saj.

Andaj, bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se ankesa e ankueses e datës 19.09.2025 është parashtruar në kundërshtim me afatin ligjor sipas nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 të LPPA-së dhe si e tillë konsiderohet e papranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të këtij ligji, ku përcaktohet se: “*Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji.*”

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.1712/2024, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankueses që të drejtohet prapë me ankesë në momentin që plotësohen kushtet ligjore që një ankesë të jetë në pajtim me legjislacionin përkatës që rregullon këtë çështje, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afateve ligjore për heshtje administrative dhe çdo herë duke respektuar afatet e parashkrimit të kërkesave të natyrës materiale.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1712/2025, datë 04/11/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses G.H;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.